



Bordi

VENDIM

Nr. 3, Datë 19.01.2017

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR GARANCITË FINANCIARE TË
PJESËMARRËSVE PËR REGJISTRIMIN NË TREGUN E ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; Kapitullit III, pika III.2.4 të “Rregullave të përkohshme të tregut Shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 139, datë 25.08.2016; dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 19.01.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e “Draft – Rregullores për Garancitë Financiare të Pjesëmarrësve për Regjistrimin në Tregun e Energjisë Elektrike”, të përgatitur nga Drejtoritë teknike,

Konstatoi se :

- Këto Rregulla hartohen nga OST dhe miratohen nga ERE në zbatim të kapitullit III, pika III.2.4 të Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, miratuar me vendim të Bordit të ERE, nr. 139, datë 25.08.2016.
- Me shkresën nr. 6583 prot., datë 18.10.2016, OST sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e Rregullave për Garancitë Financiare të Pjesëmarrësve për Regjistrimin në Tregun e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e “Draft – Rregullores për Garancitë Financiare të Pjesëmarrësve për Regjistrimin në Tregun e Energjisë Elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. KESH sh.a, OSHEE sh.a, MEI, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE

Petrit AHMETI